



Koalicioni evropian CASE përshëndet prioritizimin e padive SLAPP nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Koalicioni Kundër Padive SLAPP në Evropë, Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (ECPMF), Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), dhe Lëvizja FOL mirëpresin miratimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2026-2028, i cili u jep prioritet zgjidhjes së rasteve gjyqësore që kanë të bëjnë me Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP).

Sipas strategjisë, gjykatësit në Kosovë në të gjitha instancat duhet t'i japin prioritet rasteve të padive SLAPP, në të cilat përfshihen gazetarët, punëtorët e mediave dhe aktivistët e shoqërisë civile dhe t'i zgjidhin ato me urgjencë. Gjithashtu, strategjia priorizon rastet gjyqësore që ndërlidhen me shpifjen dhe sigurinë e gazetarëve dhe të anëtarëve të shoqërisë civile.

Strategjia është miratuar me 15 janar 2026 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), trupi më i lartë i gjyqësorit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e gjykatave dhe rekrutimin e gjyqtarëve. Strategjia tre-vjecare është një dokument detyrues për të gjithë gjyqtarët, dhe zbatimi i saj do të monitorohet nga afër.

KGJK-ja është ndër këshillat e parë gjyqësor në Evropë që u jep prioritet rasteve SLAPP, teksa afrohet afati i 7 majit 2026, për të bërë transpozimin e Direktivës së Bashkimit Evropian 2024/1069 dhe Rekomandimit të Këshillit të Evropës Cm/Rec(2024)2 kundër padive SLAPP. Kjo do të kontribuojë që paditë SLAPP të refuzohen nga ana e gjykatave në Kosovë në fazë sa më të hershme.

Kjo qasje e demonstroi përkushtimin e fortë të KGJK-së për të mbrojtur të drejtën për pjesëmarrje publike, lirinë e medias, gazetarët dhe punonjësit e tjerë të medias nga ndjekjet ligjore abusive. Shpresojmë që shembulli i njëjtë të ndiqet edhe në vendet tjera në Evropë.

Koalicioni kundër padive SLAPP në Evropë, është lëvizja më e madhe anti-SLAPP në Evropë, dhe përbëhet nga më shumë se 120 organizata në gjithë kontinentin. Së bashku, ne punojmë për të ekspozuar abuzimet ligjore kundër aktivistëve dhe avokojmë për masa gjithëpërfshirëse mbrojtëse dhe reforma ligjore.